

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 343, Datë 23.12.2025

MBI

**PLANIN E INVESTIMEVE TË SHOQËRISË OST SH.A.
PËR PERIUDHËN RREGULLATORE 2025 - 2027**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, gërma “e”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 90 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.12.2025, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Grupi i Punës me nr. 3103 prot., datë 19.12.2025, “Mbi mbylljen e procedurës për shqyrtimin e Planit të Investimeve të shoqërisë OST sh.a. për periudhën rregullatore 2025–2027”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “OST” sh.a., me shkresën nr. 6943 prot., datë 10.10.2024 (protokolluar në ERE me nr. 2098 prot., datë 11.10.2024), ka depozituar kërkesën për shqyrtimin dhe miratimin e “Planit të investimeve për periudhën rregullatore 2025–2027”, në kuadër të aplikimit për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për të njëjtën periudhë.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 247, datë 18.11.2024, vendosi fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e Planit të Investimeve të shoqërisë OST sh.a. për periudhën rregullatore 2025–2027 dhe i kërkoi shoqërisë depozitimin e dokumentacionit të plotë, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Rregulloren për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve për operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 135, datë 06.09.2017.
- Me shkresën nr. 2098/5 prot., datë 20.11.2024, ERE ka njoftuar OST sh.a. për vendimin nr. 247/2024 dhe ka kërkuar plotësime, duke evidentuar si mangësi: mungesën e analizave të detajuara mbi efektivitetin dhe koston e ulët të investimeve (paraqitur deklaratime të përgjithshme); mospërfshirjen e sqarimeve/provave që demonstrojnë lidhjen e drejtpërdrejtë të projekteve/zërave me sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit elektroenergetik; mosplotësimin e detyrimit për publikim dhe konsultim publik të planit, sipas nenit 6, gërma “f”, të Rregullores nr. 135/2017; mungesën e analizave kosto–përfitim (përfitime vetëm deklarative), si dhe mosdorëzimin e studimeve të fizibilitetit, studimeve të impaktit në mjedis dhe dokumentacionit mbi të drejtat pronësore/të shfrytëzimit, ndonëse ishte paraqitur tablo kohore e komisionimit.
- OST sh.a., me korrespondencën nr. 6943/2 prot., datë 05.12.2024 (protokolluar në ERE me nr. 2098/7 prot., datë 10.12.2024), ka depozituar përgjigje, pas shqyrtimit të së cilës ERE konstatoi se një pjesë e kërkesave vijonin të mbeteshin të paplotësuara.

- Me shkresën nr. 1952 prot., datë 03.04.2025 (protokolluar në ERE me nr. 1470 prot., datë 07.04.2025), shoqëria OST sh.a. ka paraqitur një kërkesë të re për miratimin e “Planit të investimeve për vitin 2025 dhe periudhën 2026–2028”, duke sqaruar më pas se kjo kërkesë kishte për qëllim përditësimin e planit të investimeve për periudhën 2025–2027, për shkak të ndryshimeve të projekteve të planifikuara.
- Referuar nenit 75, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, si dhe nenit 7, pika 1 dhe nenit 11, pika 1, të Rregullores nr. 135/2017 “*Rregullores së procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike*”, OST sh.a. duhet të përgatisë planet e investimeve sipas periudhave të rregullimit dhe për çdo vit pasardhës në të njëjtën kohë me aplikimin për tarifë; në këtë kuadër, ERE me shkresën nr. 1470/1 prot., datë 16.06.2025, i ka kërkuar shoqërisë sqarime për bazën ligjore të kërkesës së re dhe informacion shtesë për çështjet e mbetura të paplotësuara.
- OST sh.a., me shkresën nr. 1952/2 prot., datë 30.06.2025, ka sqaruar se plani 2025 dhe 2026–2028 është në funksion të përditësimit të “Planit 2025–2027” për shkak të ndryshimeve të projekteve; megjithatë, ERE konstatoi se: analizat kosto–përfitim vijuan të mos paraqiteshin (përfitime vetëm deklarative); detyrimi sipas nenit 6, gërma “f”, i Rregullores nr. 135/2017 mbeti pjesërisht i paplotësuar, pasi nga verifikimi në faqen elektronike të shoqërisë u konstatua se plani i investimeve nuk ishte i publikuar; të dhënat/analizat e detajuara mbi efektivitetin dhe koston e ulët të investimeve vijuan të mungonin, pasi shoqëria u shpreh në formë deklarative duke cituar dokumentet/objektivat, pa paraqitur analiza teknike.
- ERE ia adresoi sërish shoqërisë OST sh.a. kërkesat e konsideruara të paplotësuara ose pjesërisht të plotësuara me shkresën nr. 1470/2 prot., datë 16.09.2025 dhe OST sh.a., me shkresën nr. 1952/4 prot., datë 23.09.2025 (protokolluar në ERE me nr. 1470/3 prot., datë 25.09.2025), ka sqaruar se për kërkesat e ERE ishte përgjigjur me korrespondencën nr. 1952/2 prot., datë 30.06.2025.
- Sipas nenit 12, pika 1, të Rregullores nr. 135/2017, informacioni i paraqitur në planin e investimeve përdoret nga ERE për përcaktimin e Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB); në kushtet kur procedura e miratimit të planit 2025–2027 ishte ende në proces, u konsiderua që në RAB për periudhën 2025–2027 të pranohen vlerat e paraqitura në dokumentacionin e depozituar, duke pasur parasysh se, sipas pikës 4.2.6 të nenit 7 të Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit (vendimi i bordit nr. 180, datë 08.11.2017), në RAB përfshihen vetëm investime në nivele të aprovuara nga ERE; për rrjedhojë, nëse projektet e marra në konsideratë në tarifën e transmetimit të miratuar me vendimin nr. 279, datë 16.12.2024, ndryshojnë nga sa propozuar, ERE do të rishikojë CAPEX-in në periudhën pasardhëse dhe do të aplikojë korrektimet rregullatore bazuar në realizimin faktik të investimeve dhe njohjen e asetëve të futura në operim për çdo vit, sipas praktikës së mëparshme rregullatore.
- Neni 8 i Rregullores nr. 135/2017 përcakton kërkesa lidhur me përputhshmërinë e planit të investimeve me planin 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit. Bordi i ERE-s me vendimin nr. 212, datë 28.12.2017, ka miratuar planin dhjetë-vjeçar 2015–2025 të OST sh.a., të përditësuar me vendimet nr. 228/2019 dhe nr. 125/2021, dhe viti 2025 përkon me përfundimin e këtij plani.
- ERE, me shkresat nr. 1907 prot., datë 19.06.2025 dhe nr. 1907/1 prot., datë 15.09.2025, i ka kërkuar OST sh.a. depozitimin pa vonesë të Planit të Zhvillimit të Rrjetit të Transmetimit për periudhën 2026–2035, ku përfshihen edhe investimet e planifikuara për vitet 2026 dhe 2027.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 279, datë 16.12.2024 vendosi mbi miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën rregullatore 1 Janar 2025 – 31 Dhjetor 2027, prej 0.85 lekë/kWh.

- Në rast se projektet e planifikuara nga OST sh.a., për periudhën rregullatore 2025 - 2027, të marra në konsideratë nga ERE në përcaktimin e tarifës së transmetimit, të miratuar me vendimin e bordit nr. 279, datë 16.12.2024, do të kenë ndryshime nga sa propozuar nga shoqëria OST sh.a., ERE do të konsiderojë rishikimin e CAPEX lidhur me invetimet që priten të realizohen nga OST sh.a., në periudhën pasardhëse.
- Duke qenë se viti 2025 shënon dhe fundin e Planit të Zhvillimit të Rrjetit të Transmetimit për periudhën 2015-2025, vlerësohet se shoqëria duhet të paraqesë në ERE një raport mbi realizimin faktik të investimeve të parashikuara për këtë periudhë 10-vjeçare, në të cilin të përfshihen dhe sqarimet përkatëse mbi projektet e shtyra ose të parealizuar, në rast se ka të tilla
- Në këto rrethana, dhe në zbatim të kuadrit ligjor e rregullator në fuqi, vlerësohet se procedura administrative e nisur me vendimin nr. 247, datë 18.11.2024, duhet të përfundojë, ndërsa OST sh.a. duhet të vijojë me përgatitjen dhe paraqitjen pranë ERE-s të Planit të Zhvillimit të Rrjetit të Transmetimit për periudhën 2026–2035, në përputhje të plotë me ligjin nr. 43/2015 dhe Rregulloren nr. 135/2017.
- Në përputhje me nenin 90 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa marrë një vendim përfundimtar mbi themelin e çështjes, kur objekti për të cilin është nisur procedura apo qëllimi i saj është bërë i pamundur. Në këto rrethana, vlerësohet se janë përmbushur kushtet ligjore për përfundimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Përfundimin e procedurave për shqyrtimin e Planit të Investimeve të shoqërisë “OST sh.a., për vitin 2025 - 2027.
2. Shoqëria OST sh.a. duhet të depozitojë në ERE jo më vonë se muaji dhjetor 2026 Planin e Zhvillimit të Rrjetit të Transmetimit për Periudhën 2026 – 2035.
3. Drejtorja e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë shoqërinë OST sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI